

Republika e Shqipërisë

Autoriteti Kombëtar për
Certifikimin Elektronik



Udhëzues për përdorimin e nënshkrimit elektronik

Udhëzimi Nr. 001
Buletini Shtator 2011
Versioni 1.3

Ky udhëzues ka qëllim të ndihmojë në interpretimin e ligjit “Për Nënshkrimin Elektronik”. Gjithashtu, udhëzuesi synon të sqarojë se, përdorimi i Nënshkrimi Elektronik ofron më shumë siguri dhe besueshmëri në komunikimet elektronike dhe i jep çdo dokumenti elektronik vlerë ligjore.

Qëllimi i ligjit

Sipas nenit 1, qëllimi i Ligjit “Për Nënshkrimin Elektronik” është krijimi i kuadrit të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e nënshkrimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ligji ka për objekt përcaktimin e kërkesave bazë të nevojshme funksionale, teknike dhe ligjore, që duhet të zotërojnë dhe zbatojnë Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit; mënyrën e raportimit dhe regjistrimit pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE); procedurat për shfuqizimin dhe çregjistrimin e certifikatave të kualifikuara; statusin e Organizmit të Testimit dhe Konfirmimit, njohjen dhe pranimin e nënshkrimeve elektronike dhe produkteve të huaja. Ky ligj është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me Direktivën e KE 1999/93/EC për nënshkrimet elektronike.

Kreu I i Ligjit, përshkruan dispozitat e përgjithshme që tregojnë qëllimin e ligjit, cilësitë e veçanta të këtij ligji, si dhe përkufizime e terma mbi nënshkrimin elektronik.

Kreu II, përcakton thelbin dhe misionin kryesor të këtij ligji, vlerën ligjore të dokumentit të nënshkruar në mënyrë elektronike, përjashtimet nga ky ligj, pavlefshmërinë në rastet e veçanta.

Kreu III, përcakton statusin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik, mënyrat e regjistrimit dhe të raportimit pranë tij të Ofruesve të Shërbimit të Certifikimit. Ky kre, specifikon në përgjithësi rolin e Autoritetit në regjistrimin, mbikëqyrjen, inspektimin, ndërprerjen e veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimit të Certifikimit (OSHC), si dhe vleftësimin apo shfuqizimin e certifikatave të kualifikuara.

Kreu IV i Ligjit, përshkruan kushtet dhe mënyrat e ushtrimit të aktivitetit të Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit. Ky kre, i cili përfshin nenet 19-23, në mënyre të përmbledhur kalon mbi etapat e OSHC.

Kreu V është pjesë shumë e rëndësishme e ligjit, sepse tregon për mënyrën e lëshimit të certifikatave të kualifikuara, kushtet që duhet të plotësohen për prodhimin e tyre, përmbajtjen, si dhe kur dhe pse behet shfuqizimi e tyre. Po ashtu, këtu përshkruhen vultat kohore dhe qëllimi i përdorimit të tyre në dokumentet elektronike.

Kreu VI tregon përgjegjësitë ligjore të OSHC, në rastet kur kemi dëm të shkaktuar. Gjithashtu, ky kre përcakton edhe detyrimet financiare që duhet të plotësojë OSHC para dhe pas fillimit të aktivitetit.

Kreu VII përshkruan mënyrën si trajtohen të dhënat personale që përdoren për krijimin e certifikatës së kualifikuar dhe rastet kur ligji e detyron OSHC t'i dorëzojë ato në organet e përcaktuara në këtë ligj.

Kreu VIII është i ndarë në tre pjesë. Pjesa e parë përshkruan disa kushte të sigurisë së mjeteve të krijimit dhe përbërës teknike të certifikatës. Pjesa e dytë përshkruan një komponent tjetër të rëndësishëm të gjithë procesit, që është Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit, mënyra si operon, kushtet dhe kriteret për t'u njohur si i tillë. Pjesa e tretë përcakton trajtimin që i bëhet produkteve të huaja (certifikata të lëshuara nga kompani që kanë qendrën jashtë Shqipërisë).

Kreu IX dhe kreu X tregojnë për pagesat, nga kush dhe si llogariten, masat administrative në rastet e kundërvajtjeve, gjobat që aplikohen etj.

Përkufizime

1. "*Nënshkrim elektronik*" janë të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një

mënyre e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar. Një nënshkrim elektronik është një mjet verifikimi elektronik. Ky term zakonisht përcaktohet si verifikim i identitetit të zotëruesit. Çdo lloj verifikimi elektronik do të konsiderohet si nënshkrim elektronik, për sa kohë ai është i lidhur me të dhëna të tjera në forme elektronike.

2. "*Certifikatat*" janë vërtetime elektronike, të cilat lidhin kodet kontrolluese të nënshkrimeve me një person dhe konfirmojnë identitetin e tij. Ato shfaqen si kode ose algoritme që përdoren për të kontrolluar dhe verifikuar një nënshkrim elektronik.

3. "*Certifikatat e kualifikuara*" janë certifikata të lëshuara nga ofruesit e shërbimeve të certifikimit në përputhje me këtë ligj, të cilat përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Detyrimet në lidhje me certifikatat e kualifikuara janë kërkesa, të cilat lidhen me përmbajtjen e saj. Një certifikatë duhet të përmbajë informacionin e cituar në këtë dokument për t'u konsideruar e kualifikuar.

4. "*Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit*" janë personat fizikë ose juridikë, të cilët lëshojnë certifikata të kualifikuara ose vula kohore të kualifikuara.

5. "*Vulat kohore të kualifikuara*" janë certifikatat elektronike të lëshuara nga një Ofrues i Shërbimit të Certifikimit, që konfirmojnë së të dhëna të caktuara janë paraqitur në një kohë të caktuar.

6. "*Zotëruesit e kodeve të nënshkrimit*" janë personat fizikë, të cilët zotërojnë kode nënshkrimesh. Në rastin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, atyre u caktohen kodet verifikuese përkatëse të nënshkrimeve në certifikatat e kualifikuara.

Certifikimet dhe shërbimet e certifikimit

Një certifikatë e kualifikuar duhet të përmbajë këto specifitime:

- a. Të tregojë së kjo certifikatë është lëshuar si e tillë;

- b. Mjetet e identifikimit të ofruesit të shërbimit të certifikimit;
- c. Shtetin në të cilin është lëshuar;
- d. Emrin e nënshkruesit ose pseudonimin e tij;
- e. Të dhënat e verifikimit të nënshkrimit, të cilat korrespondojnë me të dhënat e krijimit të nënshkrimit që janë në zotërim të nënshkruesit;
- f. Fillimin dhe mbarimin e afatit të certifikatës;
- g. Kodin e certifikatës;
- h. Nënshkrimin e avancuar elektronik të përfaqësuesit;
- i. Kufizime të qëllimit të certifikimit, nëse ka të tilla;
- j. Përkufizime të transaksioneve që mund të kryen më këtë certifikata, nëse ka të tilla.

Veçori të nënshkrimit elektronik

Termit *nënshkrim elektronik* i është dhënë një kuptim i gjerë dhe konkretisht konsiderohen "të dhëna në formë elektronike, të cilat janë të lidhura logjikisht me të dhëna të tjera në formë elektronike dhe shërbejnë si metodë vërtetimi." Këto të dhëna mund të jenë kode, foto, vula etj. Gjithashtu, duhet të jetë e qartë së termi *nënshkrim elektronik* lidhet drejtpërdrejt me vërtetimin e të dhënave dhe nuk ka të bëjë me veprime të tilla si, përdorimi i një kodi PIN për të hyrë në një llogari bankare. Këtu nuk kemi përdorim të nënshkrimit elektronik. Ndërsa të futësh të njëjtin kod për të konfirmuar një transaksion financiar është një shembull vërtetimi i të dhënave dhe prandaj konsiderohet një nënshkrim elektronik.

Një *nënshkrim elektronik i avancuar* është një nënshkrim elektronik, i cili përmbush 4 kërkesat e mëposhtme:

1. Lidhet në mënyrë unike me nënshkruesin;
2. Është i aftë të identifikojë nënshkruesin;
3. Është krijuar në mënyrë të tillë, që nënshkruesit të ketë kontroll të vetëm mbi nënshkrimin;
4. Lidhet me të dhënat në mënyrë të tillë, që çdo ndryshim i mëtejshëm mund të dallohet.

Ndërsa, *nënshkrime elektronike të kualifikuara* janë nënshkrimet e avancuara, por që mbështeten në një certifikate të kualifikuar, pra të lëshuara nga një Ofrues i Shërbimit të Certifikimit i njohur ligjërisht si i tillë. Për lehtësi përdorimi, quhet nënshkrim elektronik.

Gjithashtu, nuk duhet harruar se, nënshkruesi nuk është personi që krijon nënshkrimin, por është personi, i cili zotëron pajisjen e krijimit të nënshkrimeve. Një shembull i zakonshëm i pajisjeve të nënshkrimeve është një smart card, flash drive, USB crypto token etj.

Vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike dhe përjashtimet

Çdo dokument elektronik, i cili përmban të dhëna elektronike që përbëjnë një nënshkrim elektronik, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me një dokument në formë shkresore.

Nënshkrimi elektronik nuk mund të përdoret në disa fusha të veçanta, siç janë veprimet juridike në fushën e së drejtës familjare dhe të trashëgimisë, veprime juridike të cilat kërkojnë një legalizim publik, një akt noterial ose që kërkojnë një autorizim nga gjykata. Ligji nuk shtrihet në çështjet e lidhura me vlefshmërinë dhe prishjen e kontratave ose detyrime të tjera ligjore në bazë të kërkesave të parashtruara nga ligje të tjera apo të

shteteve të ndryshme. Një nënshkrim elektronik konsiderohet i pavlefshëm në rastet kur nuk përmbushen kërkesat për siguri të parashikuara në ligj.

Autoriteti, regjistrimi dhe mbikëqyrja

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik është institucioni që mbikëqyr zbatimin e ligjit “Për Nënshkrimin Elektronik” dhe rregulloreve e udhëzimeve të nxjerra në zbatim të tij. Në ushtrim të funksioneve të veta, AKCE nxjerr udhëzime, të cilat normojnë dhe specifikojnë procedurat teknike dhe ligjore për mirëfunksionimin dhe ecurinë e procesit.

AKCE regjistron emrat e Ofruesve të Shërbimit të Certifikimit si dhe Organizmave të Testimit dhe Konfirmimit në përputhje me kushtet që duhet të plotësojnë këto subjekte për shërbimin e ofruar.

Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit

OSHC mund të jetë çdo person fizik ose juridik që plotëson kushtet dhe kriteret që përcakton Ligji. Një ndër kushtet kryesore që OSHC duhet t’i përmbahet është besueshmëria, e cila shprehet në atë ligjore, gjendja gjyqësore e drejtuesve dhe personelit; besueshmëria profesionale që shprehet në mënyrën e organizimit, menaxhimit të aktivitetit dhe sigurisë për vazhdimësinë në raste emergjencash; besueshmëria financiare që shprehet në garancitë e nevojshme financiare në masën që përcakton ligji për të garantuar vazhdimësinë dhe rregullsinë e procesit të lëshimit të certifikatave të kualifikuara. Një tjetër kusht është siguria teknike. Kjo mbështet kryesisht në karakteristikat e pajisjeve që përdor OSHC në prodhimin e certifikatave të kualifikuara, sigurinë teknike, mënyrën e ruajtjes së kodeve, krijimin dhe ruajtjen e çelësave private dhe publike si dhe standardet mbi të cilat mbështetet e gjithë veprimtaria e OSHC.

Regjistrimi

Çdo person fizik apo juridik, i cili përmbush kërkesat ligjore dhe teknike për të ofruar shërbimin për lëshimin e certifikatave të kualifikuara apo të vulave kohore, duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm pranë Autoritetit. Ai merr në shqyrtim kërkesat e tyre dhe bën regjistrimin sipas vlerësimit ligjor dhe teknik, duke i njohur këto subjekte si Ofrues të Shërbimit të Certifikimit. OSHC nuk kanë nevojë për licencë për fillimin e aktivitetit, por regjistrimi pranë Autoritetit është i detyrueshëm për të gjitha subjektet që duan të ushtrojnë këtë aktivitet dhe ky regjistrim duhet të kryhet para ose menjëherë me fillimin e tij.

Përdorimi vullnetar i Nënshkrimit Elektronik

Përdorimi i NE konsiderohet vullnetar, pasi rastet e përdorimit të detyrueshëm janë të paktë dhe përcaktohen me ligj.

Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit

Komponent tjetër i rëndësishëm i procesit të nënshkrimit elektronik është Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit (OTK). Ky organizëm përfaqësohet nga persona fizik ose juridik, të cilët pasi të ketë kaluar procesin e kontrollit të certifikatave, dokumenteve që garantojnë siguritë e përcaktuara se ky organizëm do të veprojë në përputhje me ligjin dhe do të garantojë një proces të paanshëm, profesional dhe korrekt, regjistrohen pranë Autoritetit. OTK aktivizohet me kërkesën me shkrim të OSHC pranë Autoritetit dhe vepron në përputhje të plotë me kërkesat e këtij të fundit në lidhje me pjesën që do të testojë dhe konfirmojë. Organizmi e testimit bën analizën e masave të sigurisë dhe procedurave të veprimit të adaptuara nga OSHC, dhe konfirmon që këto janë në përputhje me ligjin dhe standardet. Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit përpara së të bëjë testimin, njihet me dokumentacionin që ka Autoriteti, të cilin OSHC ka depozituar

pranë Autoritetit, gjithashtu kontrollon parametrat e standardet sipas “certificatë policy”, “certificate practice statement” etj, dhe ka parasysh autorizimet e mundshme të lëshuara nga Autoriteti mbi përdorime të tjera të çelësave të certifikimit të sigurisë së OSHC. Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit mban përgjegjësi individuale për konfirmimin që jep pranë Autoritetit për përmbushjen e kërkesave ligjore të një OSHC-je.

Produktet e huaja

Bazuar në nenin 54, të ligjit 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, nënshkrimet elektronike dhe produktet e huaja për nënshkrimet elektronike, njihen dhe zbatohen në përputhje me aktmarrëveshjet e lidhura nga Republika e Shqipërisë dhe shtete të tjera për njohjen e tyre dhe shkëmbimin e të dhënave. Këto produkte duhet të gëzojnë minimalisht besueshmërinë teknike dhe sigurinë që parashikohet në ligj dhe aktet të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Ligji shqiptar mbështetet në Direktivën e KE 1999/93/EC, e cila përcakton gjithë kornizën ligjore ku mbështetet legjislacioni i shteteve anëtare të BE për nënshkrimin elektronik. Direktiva synon të ndërhyjë me idenë se, zhvillimet ndërkombëtare të tregtisë elektronike kërkojnë marrëveshje që shkojnë përtej kufijve të BE, dhe në mënyrë që të mos ketë kufizime, marrëveshje me rregulla të shumanshme dhe me interes të përbashkët do të jënë të dobishme. Sipas nenit 7 të kësaj Direktive, kërkohet që shtetet anëtare të sigurojnë që certifikatat e lëshuara në vende të treta (jashtë BE) të kenë të njëjtën vlerë ligjore me ato të lëshuara në vendet anëtare të BE, por duke siguruar që njëra nga këto kushte është plotësuar:

1. Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit plotëson kërkesat e caktuara në direktivë dhe është i miratuar nga një skemë vullnetare e akreditimit të një vendi anëtar të BE.
2. Certifikatat garantojnë nga një OSHC e vendosur në një shtet të BE, që plotëson kërkesat e direktivës.
3. Certifikata ose OSHC-ja është e njohur nga një marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe mes BE dhe vendit të treta, ose nga organizata ndërkombëtare.

VKM Nr. 525, date 13.05.2009 i përmbahet dy kërkesave, pikërisht marrëveshjeve shtetërore, dhe garancisë nga një OSHC lokal. Për njehsimin e certifikatave dhe produkteve të huaja, rregullorja “Për nënshkrimin” elektronik” përcakton se, produktet dhe certifikatat e kualifikuara, të lëshuara nga një ofrues i shërbimit të certifikimit që vepron në një shtet të huaj, me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje, njihen vetëm pasi ofruesi i shërbimit të certifikimit lokal do të dorëzojë në Autoritet të gjithë dokumentacionin që kërkohet për njohjen e certifikatës së kualifikuar sipas Ligjit.

Përgjegjësia ligjore

Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit duhet të paraqiten pranë Autoritetit para ose menjëherë me fillimin e aktivitetit të lëshimit të certifikatave të kualifikuara. Ato duhet të dorëzojnë pranë autoritetit dokumentacionin e nevojshëm, ku përfshin politikat e sigurisë së mjeteve dhe të personelit, kriteret ligjore dhe teknike të ndjekura dhe të gjithë dokumentacionin e përcaktuar me ligj.

Në rastet kur një OSHC ndërpret aktivitetin, ajo duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin dhe të dorëzojë gjithë dokumentacionin që disponon pranë tij. Gjithashtu, ajo duhet të shfuqizojë të gjitha certifikatat e vlefshme, ose të kujdeset që certifikatat e vlefshme të kalojnë nën kontrollin e një ofruesi tjetër shërbimi. OSHC, detyrohet të informojë zotëruesin e kodeve të nënshkrimit për ndërprerjen e veprimtarisë së tij dhe për kalimit e certifikatave në kontrollin e një ofruesi tjetër shërbimi. Kurdoherë që OSHC adapton kritere të ndryshme do të jetë përgjegjësi e tij, dhe duhet që të informojë Autoritetin sipas aktit të informimit të inspektimit (ligji dhe rregullorja);

Lëshimi i certifikatave të kualifikuara

Pjesa me e rëndësishme e procesit të lëshimit të certifikatave të kualifikuara është identifikimi dhe marrja e të dhënave personale nga porositësi. Çdo e dhënë jo saktë nxjerr të pavlefshme certifikatën. Të dhënat që duhet të përfshihen në certifikatë përcaktohen me ligj, por me kërkesën e porositësit Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit, mund të përdorë edhe të dhëna të tjera shtesë. Gjithashtu, ligji parashikon që në certifikatë mund të përdoret edhe pseudonimi në vend të emrit, gjithmonë kjo me kërkesën e porositësit. OSHC, detyrohet me ligj të mbrojë të gjitha të dhënat personale të përdorura në certifikatë dhe për këtë merr masat përkatëse në zgjedhjen e personelit dhe mbrojtjen e kodeve, sigurinë e pajisjeve që përdor në krijimin e certifikatave të kualifikuara.

Mbrojtja e të dhënave

Ligji e detyron Ofruesin e Shërbimit të Certifikimit të mbikëqyrë ruajtjen e të dhënave dhe të sigurojë privatësinë e individit, duke rritur në këtë mënyrë besimin në përdorimin e nënshkrimeve elektronike. Ky udhëzues, vë në dukje principin, që të dhënat personale duhet të procedohen në përputhje me Direktivën Evropiane (direktiva 95/46/EC datë 24.10.1995) të mbrojtjes së të dhënave. Kjo direktivë forcon rregullat e mbrojtjes së të dhënave për Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit që lëshojnë certifikata elektronike dhe lejon përdorimin e një pseudonimi në vend të emrit të kërkuarit. Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit, detyrohet të mbledhë të dhënat personale vetëm nëpërmjet subjektit ose me miratimin e tij nëpërmjet një personi të tretë të autorizuar prej tij. Gjithashtu, Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit duhet të kërkojë vetëm informacionin e nevojshëm që nevojitet për lëshimin e certifikatës dhe duhet t'i përdorë ato vetëm për këtë arsye, ose për mirëmbajtjen e certifikatës.

Për ruajtjen e kodeve të nënshkrimeve dhe prodhimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, përdoren mjetë të sigurta të krijimit të nënshkrimeve, të cilat identifikojnë të dhëna të rreme edhe nënshkrime të falsifikuara, dhe ofrojnë mbrojtje nga përdorimi i paautorizuar i kodeve të nënshkrimeve.

Ligji për nënshkrimin elektronik i lejon Autoritetit të kërkojë nga Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit të dhënat personale të zotëruesit të certifikatës për rastet e mëposhtme:

- a) kur kjo është e nevojshme për ndjekjen e veprave penale ose të shkeljeve ligjore dhe kur një kërkesë e tillë vjen nga organet e ngarkuara me ligj për hetimin e tyre;
- b) për të shmangur rrezikun që i kanoset sigurisë kombëtare ose rendit publik;
- c) për të kryer detyrat që u ka ngarkuar ligji autoriteteve fiskale, doganore apo organeve të tjera në hetimin e shkeljeve ligjore;
- d) kur për një gjë të tillë vendos gjykata;

Në lidhje me masat e mbrojtjes dhe arkivimit të të dhënave, Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit duhet të raportojë pranë Autoritetit periodikisht në përputhje me detyrimin ligjor që ai ka.

Detyrimi për informim

Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit kanë detyrim ligjor, që para lëshimit të certifikatës së kualifikuar të informojnë me shkrim kërkuuesin në lidhje me atë, se vlera e dokumentit elektronik të bashkëlidhur me nënshkrim elektronik do të ketë vlere të njëjtë ligjore me atë të dokumentit të nënshkruar me dorë, me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj, përdorimi i në është vullnetar dhe dokumenti do të nënshkruhet përsëri nëse niveli i sigurisë ka renë.

Kostot dhe tarifat

Tarifat që duhet të paguajnë subjektet e regjistruara nga Autoriteti për shërbime të caktuara janë llogaritur në bazë të orëve të punës së punonjësve të Autoritetit, duke marrë parasysh kostot reale kohore dhe materiale të shpenzuara për shqyrtimin e dokumentacionit, për inspektimet apo kontrollet e detyrueshme. Këto tarifa janë në

përputhje me VKM Nr. 503, datë 13. 05. 2009, “Për miratimin e tarifave për shërbimet që ofrohen nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik”.

Masat administrative

Neni 56 i Ligjit, përshkruan hollësisht rastet kur AKCE merr masa administrative ndaj OSHC. Shkeljet që nuk përbëjnë vepra penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobe 1 ose 2 milion lekë. Kur Autoriteti e gjykon të arsyeshme se, shkeljet janë në masë të tillë që cenojnë integritetin dhe besueshmërinë e ofruesit të shërbimeve të certifikimit, ndërpret përkohësisht, plotësisht, apo pjesërisht veprimin e këtij të fundit. Ankimi kundër masave administrative behet brenda 10 ditëve tek ministri që mbulon këtë fushë dhe kundër vendimit të tij mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve në gjykatë.